



REPUBLIKA E KOSOVES
LIPJAN



VISIT LIPJAN BLINAJË

🏠 Rr. Shqipëria 28, 14000 Lipjan, Kosovë

☎ 038 200 41 508

✉ infokomuna.lipjan@rks-gov.net

🌐 <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>





BLINAJA, LIPJAN

Territori i Blinajës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, 15 km në perëndim të qytetit të Lipjanit.


Sipërfaqja e Blinajës është 5500 ha dhe kryesisht shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit.

Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m.

Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore.



Peizazh nga Blinaja





Peizazh nga Blinaja

Bota, **bimore**

Bota e gjallë bimore e Blinajës përfaqësohet nga një numër i madh llojesh autoktone, si dhe nga fauna e egër. Vegjetacioni është i begatshëm dhe i llojllojshëm si rezultat i proceseve historike evolutive dhe kushteve mjaft të përshtatshme gjeografike, orografike, klimatike, gjeologjike dhe pedologjike. Karakterizohet me një terren të brezit kodrinor me thyerje mesatare dhe pa pjerrësi të

Hidrografia përbëhet nga përroska të vogla që gjatë verës thahen tërësisht. Janë të ndërtuara 33 penda ujëmbledhëse me qëllim të furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës.

Peizazh nga Blinaja



Prania e 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse





Pjesa dërrmuese e sipërfaqes pyjore (mbi 90%) janë pyje cungishte, ndërsa pjesa e mbetur e sipërfaqes janë pyje të lartë, livadhe, kullota, sipërfaqe



Pjesëmarrja e llojeve ne vëllimin e përgjithshëm në nivel të njësisë menaxhuese dominohet kryesisht nga dushqet, ku qarri ka pjesëmarrjen më të madhe 49%, bunga 33% e më pak shparthi me 6%, po ashtu lloje të tjera fletorësh si ahu, bliri etj., zënë rreth 11% dhe pjesën e mbetur e zë pisha e zezë. Llojet më reprezentativë që kultivohen në njësinë menaxhuese të Blinaja-s, janë kaprolli (*Capreolus capreolus*), derri i egër (*Sus scrofa*), dreri bri lopatë (*Dama dama*),



Kushtet natyrore mundësojnë kultivimin e kafshëve dhe shpezëve të egra për gjueti, që e bëjnë këtë njësi menaxhimi një lokacion të mirë për gjueti rekreative.





Kushtet natyrore mundësojnë kultivimin e kafshëve dhe shpezëve të egra për gjueti, që e bëjnë këtë njësi menaxhimi një lokacion të mirë për gjueti rekreative. Blinaja përfaqëson një lloj të mbyllur të vendgjuetisë, çka do thotë se nuk ka lëvizje të lirë të faunës së kultivuar dhe grabitqarëve natyror. Mungesa e grabitqarëve e bën gjuetinë si mjetin kryesor për të kontrolluar numrin e kafshëve apo ruajtjen e ekuilibrit biologjik, duke mos lejuar shtimin e numrit të madh të kafshëve mbi ekuilibrin biologjik dhe mbi











VISIT BLINAJA

Lipjan – Blinaje 14KM